



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

Data 28.01.2025
Nr. 184/2 Prot.

FTESË PËR NEGOCIATË

PËR

AGJENCITË E SPECIALIZUARA/ORGANET E MEDIAVE VIZIVE PËR TRANSMETIM E REKLAMAVE, SPOTEVE DHE MATERIALEVE INFORMUESE NGA OPERATORËT RADIOTELEVIZIVË DHE MEDIAN ON DHE OFF LINE BAZUAR NË WEB-E, NË KUADËR TË ZGJEDHJEVE PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË DATËS 11 MAJ 2025.

Bazuar në pikën 6 të vendimit nr.1195, datë 05.08.2008, “Për blerjen, zhvillimin prodhimin e bashkëprodhimin e programeve apo të reklamave për transmetim nga operatorët audiovizivë ose botimin në median e shkruar dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore”, të Këshillit të Ministrave, vendim nr. 214 datë 20.12.2024, “Për miratimin e strukturës së shpenzimeve buxhetore, për programin “Zgjedhjet e përgjithshme dhe vendore” të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Vendimin nr.206, 207 dhe 208 të datës 11.12.2024, “Për miratimin e Programit për Edukimin, Informimin dhe Ndërgjegjësimin e zgjedhësve, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2025”, marrëveshjes me nr. 1893 prot, datë 24.03.2023 “Mbështetje e Parlamentit dhe edukimit qytetar. Mbështetje për KQZ-në” të lidhur me qeverinë Zviceriane si dhe urdhrin të delegimit të detyrave me nr. 6 datë 09.01.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në cilësinë e nëpunësit të autorizuar.

OBJEKTI

“Transmetimi i reklamave, spoteve dhe materialeve informuese nga operatorët radiotelevizivë, trasmetimin në median on dhe off line bazuar në web-e, në rrjetet e komunikimit elektronik bazuar në mesazhet për edukimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e zgjedhësve brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë.”



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në kuadër të fushatës edukuese të zgjedhësve brenda dhe jashtë vendit do të trasmetojë reklamat, spotet dhe materialet informuese për periudhën zgjedhore. Nisur nga objekti i ftesës ju sqarojmë se trasmetimi do të realizohet ne media televizive, radio, on dhe off line, elektronike.

1- Trasmetimi nga operatorët në median on dhe off line bazuar në web-e, në rrjetet e komunikimit elektronik.

Objekti për pjesën e shërbimit të trasmetimit në mediat on dhe off line bazuar në web-e të spoteve dhe banerave informuese, kjo në kuadër të fushatës edukuese për zgjedhësit nga jashtë vendit dhe mjete të komunikimit kryesor për informimin dhe edukimin e zgjedhësve nga jashtë vendit mbeten rrjetet sociale të institucionit dhe spotet, reklamat onlinë.

2- Trasmetimi nga operatorët radiotelevizivë

Objekti për pjesën e shërbimit të trasmetimit në radiotelevizione: Trasmetimin e reklamave, spoteve dhe materialeve informuese nga operatorët radiotelevizivë, në kuadër të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025”.

1. Ftesa për negociata për : Trasmetimin nga operatorët në median on dhe off line bazuar në web-e, në rrjetet e komunikimit elektronik.

A- Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Adresa: Rruga Ibrahim Rugova, nr.4

Tel/Fax: +355 4 4510810

E-mail: erminal.allushi@kqz.gov.al

Adresa e Internetit: www.kqz.gov.al

KQZ do të zhvillojë procedurën për trasmetimin nga operatorët në median on dhe off line bazuar në web-e, në rrjetet e komunikimit elektronike.

B- Periudha e realizimit të shërbimit: 5 (pesë)muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

C- Fondi limit i përcaktuar: fondit limit i procedurës është në vlerën është 25,000,000 (njëzet e pesë milion) lekë me TVSH.

D- Data e zhvillimit dhe pranimit përfundimtar të ofertave dhe dokumentacionit do të jete 31.01.2025 ora 15:30.

Shënim: Dokumentacioni/ofertat duhet të vijnë të gjitha të mbyllura në zarf jo transparent, të firmosura dhe vulosura në emrin dhe adresën e subjektit dhe me shënimin: Mos e hapni, me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni.

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj dhe dokumentacionin përkatës për këtë objekt me këto të dhëna (specifikimet teknike të mallit/shërbimit/punës):

E- Shërbimet që kërkohen të realizohen:

Rruga "Ibrahim Rugova", Nr. 4, Tiranë, Shqipëri |



| info@kqz.gov.al | kqz.gov.al | +355 4 4510810

Përshkrimi i shërbimit është: Informimi, Edukimi dhe Ndërgjegjësimi i Zgjedhësve në median on dhe off line bazuar në web-e, me qëllimin për tu ardhur në ndihmë zgjedhësve, që të informohen për hapat e procesit zgjedhor, kërkimin e emrit në listat e zgjedhësve, dokumentet që duhen në ditën e zgjedhjeve, mënyrën e plotësimit të fletës së votimit, krimet zgjedhore, e të tjera. Videot dhe imazhet informuese, duhet të përmbajnë në fokus informacion të plotë dhe të detajuar për procesin zgjedhor të datës 11 Maj 2025 për zgjedhjet për deputetët e Kuvendit të Shqipërisë. Kjo fushatë duhet të ketë përqëndrim të lartë për zgjedhësit me vendbanim jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë duke qenë se votojnë për here të parë nga vendi ku ata jetojnë. Spotet duhet të transmetohen në përputhje me standardet dhe teknikat më të avancuara të filmimeve. Cilësia e transmetimit duhet të jetë e përshtatshme për formatin e transmetimit Full HD.

Karakteristikat:

- Gjatësia mesatarisht 45 - 60 sekonda.
- Cilësia full HD.
- Kualiteti 4K.
- Voice Over Profesional.
- Video informuese informuese do të jenë të shoqëruar nga një seri imazhesh statike me mesazh zgjedhor.
- Videot janë të përshtatura në gjuhën e shenjave dhe të minoriteteve
- Operatori duhet të dorëzojë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, materialet e përgatitura në CD ose usb në format të editueshëm dhe në formatin HD.

F- Për realizimin e këtij shërbimi Autoriteti Kontraktor kërkon nga operatorët ekonomik dokumentacionin përkatës si më poshtë:

- 1) Ekstrakti historik i regjistrit tregtar.
- 2) Vërtetim për statusin aktiv.
- 3) Deklaratë mbi konfliktin e interesit.
- 4) Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur.
- 5) Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike me të cilën merr përsipër se ka kapacitetet e nevojshme për të konceptuar, realizuar dhe siguruar transmetimin e spoteve.
- 6) Kontrata të ngjashme të mëparshme tre vitet e fundit.
- 7) Projekt propozimi për realizimin e shërbimit

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre të lëshuara jo më vonë se 3 (tre) muaj nga data e publikimit të njoftimit për negociatë. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shënim: Përzgjedhja e ofertave do të bëhet sipas pikës nr. 7 dhe 12, të VKM nr.1195 datë 05.08.2008.

G- Kriteret e vlerësimit sipas pikëve:

- Kriteret e përgjithshme: 20 pikë
- Ekperianca në shërbimet e ngjashme (kontratat e paqaritura) 30 pikë
- Oferta financiare e shoqëruar me Projekt propozimin për realizimin e kontratës 50

Oferta ekonomike do të jetë e paraqitur në monëdhën lekë.

Kjo ftesë për negociatë do të publikohet në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në adresën: www.kqz.gov.al si dhe do ju dërgohet edhe me postë zyrtare operatorëve.

Jemi në pritje të konfirmimit tuaj për negociim.

2. Ftesa për negociatë për: Trasmrimi nga operatorët radiotelevizivë

A- Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Adresa: Rruga Ibrahim Rugova, nr.4

Tel/Fax: +355 4 4510810

E-mail: ermina.allushi@kqz.gov.al

Adresa e Internetit: www.kqz.gov.al

KQZ do të zhvillojë procedurën për trasmrimin nga operatorët radiotelevizivë.

B- Periudha e realizimit të shërbimit: nga data e nënshkrimit të kontratës deri më datë 11 maj (3.5 muaj)

C- Fondi limit i përcaktuar: fondi limit i procedurës është në vlerën është 90,399,080 (nëntëdhjetë milion e treqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e tetëdhjetë) lekë me TVSH.

D- Data e zhvillimit dhe pranimit përfundimtar të ofertave dhe dokumentacionit do të jete 04.02.2025 ora 15:30.

Shënim: Dokumentacioni/ofertat duhet të vijnë të gjitha të mbyllura në zarf jo transparent, të firmosura dhe vulosura në emrin dhe adresën e subjektit dhe me shënimin: Mos e hapni, me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni.

Jeni të lutur të paraqisni ofertën tuaj dhe dokumentacionin përkatës për këtë objekt me këto të dhëna (specifikimet teknike të mallit/shërbimit/punës):

E- Shërbimet që kërkohen të realizohen:

Përshkrimi i shërbimit është: Trasmrimin e reklamave, spoteve dhe materialeve informuese nga operatorët radiotelevizivë, në kuadër të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 11 maj 2025". Videot/spotet përmbajnë në fokus informacionin e plotë dhe të detajuar për procesin zgjedhor të datës 11 maj 2025. Videot/spotet duhet të transmetohen në përputhje me standardet dhe teknikat më të avancuara të filmimeve dhe në formatin Full HD.

Karakteristikat:

- Kohëzgjatja e trasmimit të videove (spote) mesatarisht 35 - 60 sekonda.
- Trasmrimi full HD.
- Kualiteti 4K.
- Videot informuese janë shoqëruar nga një seri imazhesh statike me mesazh zgjedhor.

- Videot janë të përshtatura në gjuhën e shenjave.
- Videot janë të përshtatura me titra në gjuhën e pakicave që jetojnë në Shqipëri, përkatësisht në 8 gjuhë (greke, malazeze, bullgare, serbe, rome, maqedonase, arumune dhe boshnjake).
- Videot përmbajnë mesazhe informuese dhe sensibilizuese për zgjedhësit brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

F- Për realizimin e këtij shërbimi Autoriteti Kontraktor kërkon nga operatorët ekonomik dokumentacionin përkatës si më poshtë:

- 1) Ekstrakti historik i regjistrit tregtar.
- 2) Vërtetim për statusin aktiv.
- 3) Deklaratë mbi konfliktin e interesit.
- 4) Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur.
- 5) Mediaplanet/ fashat orare mbi të cilat ka ofertuar.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre të lëshuara jo më vonë se 3 (tre) muaj nga data e publikimit të njoftimit për negociatë. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose të dokumenteve të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shënim: Përzgjedhja e ofertave do të bëhet sipas pikës nr. 7 dhe 12, të VKM nr.1195 datë 05.08.2008.

G- Kriteret e vlerësimit sipas pikëve:

- Kriteret e përgjithshme: 20 pikë
- Oferta financiare e shoqëruar me diaplanin me fashat orare të propozuara për transmetim 80 pikë

Oferta ekonomike do të jetë e paraqitur në monedhën lekë.

Kjo ftesë për negociatë do të publikohet në faqen e internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në adresën: www.kqz.gov.al si dhe do ju dërgohet edhe me postë zyrtare operatorëve.

Jemi në pritje të konfirmimit tuaj për negociim.

Sekretar i Përgjithshëm

Majlinda ÇELMETA

(Në mungesë dhe me urdhër)

